

PERMBLEDHJE JOTKENIKE E VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS PER AKTIVITETIN:

**"SHFRYTËZIM GURI GELQEROR TE
MERMERIZUAR"**

Vendodhja : Në anën lindore të malit Mëlovë,
fshati Mëlovë, Njësia Administrative Gjerbës,
Bashkia Berat

Kërkues, Subjekti: "STONE PRODUCTION"
Sh.p.k


Hartoi raportin:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k




Altin Ahmeti

(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)



Ing. Elidiana Shehu

(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



Janar, 2018

Pasqyra e lëndës

Hartoi raportin:.....	0
HYRJE.....	2
Kapitulli 1: QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR	3
1.1 Qëllimi i projektit.....	3
1.2 Qëllimi i hartimit të raportit VNM.....	3
1.3 Legjislacioni i konsultuar për realizimin e VNM.....	3
1.4 Metodika e zbatuar	5
Kapitulli 2 : PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK	6
2.1 Vendodhja e objektit	6
2.2 Ndërtimi gjeologjik i vendburimit.....	7
2.4 Hidrogjeologjia e vendburimit	8
2.5 Kushtet tekniko – minerare të vendburimit.....	8
2.6 Mënyra e shfrytëzimit	9
2.6.1 Përzgjedhja e mënyrës së shfrytëzimit.....	9
2.6.2 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës	9
2.6.4 Sistemi i shfrytëzimit	10
Elementet e sistemit te shfrytezimit.....	10
2.6.5 Përcaktimi i mjeteve të ngarkimit të sterileve.....	10
2.7 Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë	11
2.8 Pjesa ndërtimore	12
Kapitulli 3: PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONË.....	13
3.1 Mjedisi fizik	13
3.1.1 Gjeologjia.....	13
3.1.4 Hidrologjia	14
Kapitulli 4: IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË VEPRIMTARISË.....	15
4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin ndikimeve në mjedis	15
4.2 Metodika e kategorizimit të ndikimeve të identifikuar (sinjifikanca)	15
4.3 Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis të veprimitarisë	16

HYRJE

Subjekti **“STONE PRODUCTION”** sh.p.k. është një shoqëri e huaj me aktivitet shumëvjeçar në vendin tone. Kompania është themeluar në vitin 1980 dhe ka seli në zonën industriale të Drames në Greqi. Është bërë një nga prodhuesit kryesorë të mermerit të bardhë në tregun botëror. Kompania është e specializuar kryesisht në prodhim, përpunimin dhe shitjen e mermerit të bardhë, gjysmë të bardhë dhe Graniteve. Kompania është aktive në nxjerrjen përpunimin dhe shitjen e produkteve të përpunuara, mermere të granitit, në Greqi dhe jashtë saj. Produktet e prodhimit eksportohen me shumicë në Azinë Lindore, Brazil dhe tregjet Europiane. Ajo tani konsiderohet si një biznes me të lartë në tregun ndërkombëtar në sektorin e mermerit, për shkak të orientimit intensiv drejt eksporteve. Kompania aplikon metoda moderne në procesin e shfrytëzimit dhe metoda miqësore me mjedisin, duke zbatuar projekte restaurimi mjedisore në guroret që ushtrohet aktiviteti i nxjerrjes.

Nëpërmjet projektit të paraqitur shoqëria synon shfrytëzimin e Karrierës sipërfaqësore « Shfrytëzim Guri Gelqeror të mermerizuar », me vendodhje në anën lindore të malit të Mëlovës, fshati Mëlovës, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, për shfrytëzimin e blloqeve të mermerit për qëllime eksporti jashtë vendit, kryesisht Greqi.

Objekti gjendet në zonën minerare nr. 862/2, miratuar në planin vjetor mineral të vitit 2015 të Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, zonë për të cilën shoqëria **“STONE PRODUCTION”** sh.p.k. është shpallur fituese (shkresë nr.809 prot: MEI dt 05.02.2015 dhe nr.1756 prot AKB: dt 03.02.2015) dhe aktualisht subjekti duke mos aplikuar në kohë për Rishikimin e Lejes Mjedisore, do aplikojë për Leje të Re Mjedisore.

Vendburimi i gurit gelqeror të mermerizuar ndodhet në territorin e fshatit Mëlovë, të Njesisë Administrative Gjerbës, bashkisë Skrapar, në të majtë të rrugës që lidh fshatin Mëlovë me fshatin Zaloshnjë rreth 1 km largë fshatit Mëlovë. Kjo zonë është një pjesë e shpatit perëndimor të malit të Zaloshnjës kufizuar me kuotat 1180 dhe ngjitet në lartësinë e malit në afërsi të kuotave 1500 m. Në pjesën lindore ky objekt kufizohet nga rruga automobilistike, kurse nga ana Perëndimore, Veriore dhe Jugore kufizohet me shpatin e malit të Zaloshnjës. Vendburimi i Gurit Gelqeror të mermerizuar ndodhet në verilindje të qytetit të Çorovodës, në distancë 10 km largë nga qyteti. Shtrirja e kësaj sipërfaqeje është VeriPerëndim-JugLindje.

Aktualisht shoqëria është në proces aplikimi për Leje të Re mjedisore dhe në zbatim të legjislativës në fuqi ajo duhet beje Njehsimin e Lejes së vjetër Mjedisore me Miratim të VNM-se Paraprakë apo Deklaratë Mjedisore në varesi të sipërfaqes së karrierës, aplikim për Konsultimin me Publikun dhe me pas aplikimin pranë sporteve të QKB-së për leje të Re Mjedisore, pasi subjekti nuk ka shtuar sipërfaqe dhe kapacitete.

Kapitulli 1: QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR

1.1 Qëllimi i projektit

Projekti i paraqitur nga shoqëria “**STONE PRODUCTION**” sh.p.k. ka për qëllim shfrytëzimin e Karrieres siperfaqesore të objektit “Mëlovë” për shfrytëzimin e gelqeroreve të mermerizuar, i cili gjendet në zonën minerare 862/2 date 26.05.2005 miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2015 të Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës.

1.2 Qëllimi i hartimit të raportit VNM

Synimi kryesor i përgatitjes së raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikohen ndikimet e mundshme negative të zbatimit të projektit në vlerat natyrore të zonës ku do të zbatohet si dhe vlerësimi i performancës mjedisore të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij.

Ky vlerësim arrihet përmes:

- Evidentimit të pikëprerjeve dhe bashkëndimit të projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Identifikimit të statusit mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti;
- Përshkrimin të vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit;
- Identifikimit të ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit ekzistues pritës, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

1.3 Legjislacioni i konsultuar për realizimin e VNM

Për realizimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të veprimtarisë së propozuar u konsultuan dokumente mjedisore që lidhen me politikat shtetërore të mbrojtjes së mjedisit, zonës në të cilën do të zhvillohet .

Përgatitja e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të aktivitetit të propozuar është kryer duke u bazuar në aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 25, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.
- Ligj nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E VNM-se

- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili ka për qëllim të mbrojtë mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre.
- Ligj nr.9587 datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet. Ligji kërkon që veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura ose jo të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t’u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore.
- Ligj nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” përmes të cilit synohet të sigurohet mbrojtje e veçantë për përbërës të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Zhvilluesit e projekteve dhe veprimtarive duhet të zbatojnë projektet e tyre në përputhje me statusin e mbrojtjes së zonave të mbrojtura (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë);
- Ligj nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma.
- VKM nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”.
- VKM nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare” i cili përcakton monumentet natyrore në nivel qarku dhe rrethi që duhet të mbrohen nga veprimtaritë e ndryshme (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë).
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, i cili përcakton rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).
- Vendim nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

Akte sektorialë

- Ligji nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM nr. 942 datë 17.11.2010 “Për Miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve në zonat e hapura”.
- VKM nr 362 dt 29.04.2011”Per miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit , menyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve Minerare”.

1.4 Metodika e zbatuar

Për të hartuar pjesën përshkrimore të raportit, vlerësimin e ndikimeve dhe planin e menaxhimit u përdorën dhe analizuan të dhënat e përftuara nga vërtetimet në terren si dhe burime sekondare informacioni. Matjet në terren përfshijnë: matjen e nivelit egzistues të zhurmës; vlerësimin e cilësisë së ujërave në zonë; vlerësimin e mbulesës bimore në zonën e projektit si dhe vërtetime për cilësinë e habitatit dhe prezencën e specieve faunistike. Gjatë vërtetimit u vlerësuan edhe ndikimet egzistuese në zonën e projektit.

Përshkrimi i projektit është bazuar në projektin tekniko - minerar dhe në të dhënat e studimeve përkatëse në lidhje me hidrologjinë, topografinë dhe gjeologjinë inxhinierike të terrenit në të cilin propozohet të zhvillohet aktiviteti.


Kapitulli 2 : PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK

2.1 Vendodhja e objektit

Vendburimi i gurit gelqeror te mermerizuar ndodhet ne territorin e fshatit Mëlovë, te Njesise Administrative Gjerbës, bashkise Skrapar, ne te majte te rruges qe lidh fshatin Mëlovë me fshatin Zaloshnje rreth 1 km large fshatit Mëlovë . Kjo zone eshte nje pjese e shpatit perendimor te malit te Zaloshnjes kufizuar me kuotat 1180 dhe ngjitet ne lartetin e malit ne afersi te kuotave 1500 m. Ne pjesen lindore ky objekt kufizohet nga rruga automobilistike , kurse nga ana Perendimore, Veriore dhe Jugore kufizohet me shpatin e malit te Zaloshnjes. Vendburimi I Gurit Gelqeror te mermerizuar ndodhet ne verilindje te qytetit te Çorovodes, ne distance 10 km large nga qyteti. Shtrirja e kesaj sipërfaqeje eshte VeriPerendim-JugLindje .

Zona bën pjesë në planshetin e hartës topografike të shkallës 1:25 000 me Objekt (Melove) dhe zë një sipërfaqe prej **1,3594 km²**.

Ajo kufizohet nga pikat me koordinata si më poshtë:



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E VNM-se

Pika	1	2	3	4	5	6
Y	44 39 160	44 38 556	44 39 026	44 39 501	44 39 880	44 39 680
X	44 93 005	44 94 515	44 94 735	44 94 227	44 93 155	44 92 705
Siperfaqja e licencuar S=1.359 km²						

Administrativisht, objekti gjendet në territorin e Njesise Administrative Gjerbës, të rrethit të Skraparit. Fshatrat më të afërta janë: Zaloshnjë, Gostëncke etj.

2.2 Ndërtimi gjeologjik i vendburimit

Siperfaqja ne te cilen zhvillohet aktiviteti i shfrytezimit eshte fonnacion shkembor karbonatik i perfaqshuar nga gelqerore te mermerizuar dhe koralore masive. Zona ne te cilen ndodhet objekti perfaqshon nje pjese te shpatit te malit te Korite, i cili perfaqshon vazhdimin e malit te Tomorit dhe ben pjese ne zonen Gjeologo-Tektonike Jonike .

Zona minerare, ku jane kryer dhe punime kerkim zbulimi dhe shpime te ndryshme, dhe eshte zhvilluar aktiviteti minerar i shfrytezimit me karriere, ben pjese ne shpatin lindor te malit qe nderpritet nga qafa e Devries, i cili ka nje shtrirje te pergjitheshme VP-JL me azimut 320°- 340°, me nje gjatesi rreth 15 km dhe gjeresi qe shkon 3-5 km. Siperfaqja e tij eshte rreth 42,75 km² .

Per studimin gjeologjik te zones dhe kryesisht te zones minerare te lejuar per shfrytezirn te gelqeroreve Melove, te rrethit Skrapar qe ndodhet ne Vcrilindje te qytetit te Çorovodes , me punimet c kerkim — zbulimit dhe te shfrytezirn te realizuara nga subjekti gjate periudhes dhjetevjecare, jane gumbulluar materiale te mjaftueshme per te saktësuar ndertimin gjeologjik te vendburirnit, dhe jane plotesuar kushte te mjaftueshme njohje ne sigurimin e ndertimit te karrieres per shfrytezirn te gurit gelqeror ne kushtet me optimale. Ne ndertimin gjeologjik to objektit marrin pjese depozitimet karbonatike te Kretakut te siperm (Cr₂), qe perfaqesohen nga gelqerore masive me rudiste dhe geqerore te dolornitizuar. Ne pjese te vecanta keta gelqerore paraqiten shtresore dhe pllakore biomikritike me globotrunkana dhe me gelqerore turbiditike.

Me ne jug te zones se shfrytezirn dalin edhe depozitimet karbonatike te Eocenit, (Pg₂) qe perfaqesohen nga gelqerore biomikritike dhe turbitidike keto depozitirne vendosen mbi depozitimet e Kretakut te siperm te cilet me tipike jane per zonen e Kruje-Dajtit dhe ate Jonike. Ne siperfaqe keto gelqerore jane te eroduar nga agjentet atmosferike ku vepron fuqishem edhe fenomeni i karstit i cili krijon zgavra, gropa e hinka te mbushura me material argjilor (toka te kuqe).

Keto gelqerore jane me strukture kristaline me ngjyre bezhe te celur kryesisht organogjene te rikristalizuar, jane kompakte ne brendesi dallohen edhe mikrocarje te mbushura me material argjilor (toka te kuqe).

2.4 Hidrogeologjia e vendburimit

Sic u permend me siper vendburimi gjeografikisht perfaqeson nje strukture monoklinale, ne formen e nje shpati plotesisht te drenuar dhe nuk ka permbajtje ujrash ne te, me perjashtim te ndonje sasie te vogel ne kuotat e poshteme mbi kuoten e rruges qe vjen nga Milova dhe shkon ne Zaloshnje dhe te proskave, qe ndodhen ne zonen e tij.

Per nga pikparnja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku ushtrohet aktiviteti minerar ndodhet nje prroske e thelle rreth 20 m ne te cilen ne stinen e thate nuk rrjedhin ujra.. Kur ka rreshje ne to rrjedhin me rrernbim ujra siperfaqesore per shkak te pjerresise se madhe te terrenit

Per nevoja teknologjike, eshte realizuar nje shpim me sonde, me gjatesi 900 ml, me anen e te cilit sigurohet uje teknologjik. Prania e ujrave te rreshjeve te shiut nuk veshtiresone kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato mund te rrjedhin ne drejtim te shpatit te kodres si dhe pergjate rrugeve qe lidhin e do te ndertohet per lidhjen e objektit me ate ekzistuese. Rreshjet e deboret veshtiresojne kryesisht transportin e materialit te prodhuar ne karriere, i cili per arsye te tyre, nderpritet per intervale te kufizuar kohe

Persa i perket kryerjes se proeeseve teknologjike te shpimit te birave konturuese apo udhezuese, rrezimit, shkeputjes se materialit dhe blloqeve ne karriere zbankimit the ngarkimit te tyre ndikimi i rreshjeve te deboret do te jete reiativisht i kufizuar me perjashtim te rasteve te temperaturave te u]ta dhe ngricave.

Sipqefaqa e vendit qe do te shrytezohet eshte pothuajse e zhveshur nga birnesia, Rriten vetem pak shkurre te vogla barishtore. Te gjitha llojet e birneve, (qe rriten perreth objektit jane te karakterit lokal pa ndonje vecori dalluese dhe qe nuk gezojne ndonje status te vecante mbrojtjeje. Brenda zones se shfrytezimit jane te zhvilluar ne rrenyre te kufizuar shkurret dhe bimet lokale. Ne pjesn fundore te objektit ne zone Vcriore dhe Veriperendimore pergjate, rritcn bimcsi me te larta te tipit te shkozës dhe ahut Kjo pjese e zone nuk parashikohet te preket nga shfrytezimi.

2.5 Kushtet tekniko – minerare të vendburimit

Objekti i gurit Gelqeror, te dhene per shfrytezim, ndodhet ne nje siperfaqe, ku kane perfunduar punimet e hapjes, pergatitje dhe zbulimit ne nje mase te konsiderueshme, ne hapesiren e nevojshme, ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti i shfrytezimit.

Gelqeroret ndodhen ne trajte blloqesh massive me ndonje shtresezim te vogel, e lidhur kjo me kushtet gjeologjike te formimit te vendburimit. Objekt per shfrytezim eshte lidhur me rrugen e transportit ku kalon rruga rurale qe lidh Çorovoden me fshatrat Mëlovë-Gjerbës . Vete objekti eshte ne aktivitet shfrytezimi dhe me sigurimin e shteses se afatit kohor do te vazhdoje pergatitjen e metejshme per te siguruar nxjerrjen e prodhimit te planifikuar.

Per vazhdimin e hapjes dhe shfrytezimin e vendburimit do te zgjaten me teje rruget e brendshme ekzistuese te karrieres, si dhe do te sigurohet ruajtja e lidhjes me rrugen rurale Çorovode, e cila megjithese eshte e paasfaltuar , eshte e shtruar me çakell nga vete subjekti dhe i kushtohet nje rendesi e vecante ne mirembajtjen e saj.

2.6 Mënyra e shfrytëzimit

2.6.1 Përzgjedhja e mënyrës së shfrytëzimit

Per te gjykuar dhe percaktuar drejt menyren e shfrytezimit te objektit eshte marre baza e informacionit dhe eksperiencia e deritanishme , ku eshte kryer per cdo shkalle marrja e te dhenave fktike mbi llogaritjen e rezervave, volumin e zbulimit dhe koeficientin mesatar te nxjerrjes.

Duke marre ne konsiderate elemente te tjere si : Topografine sasine e rezervave, karakteristikat gjeomekanike te shkembinjve, elementet e shtruarjes dhe koeficientin paraprak te zbulimit per heqjen e dherave dhe shkembinjve me carje ne siperfaqe, sipas shkalleve, eshte parashikuar vazhdimi I shfrytezimit me karriere I rezervave te llogaritura te objektit me kuota te poshtem +1167 m dhe koute te siperme+ 1300 m.

Kryerja e punimeve te shfrytezimit ne qiell te hapur, projektohet qe te vazhdoje edhe ne periudhen kohore shtese, sepse favorizohet nga:

- Renia e formacioneve, qe ndertojne pakon productive
- Fortesia e pershtatshme e mbulesave deluvionale , dhe e formacioneve te prishura ne siperfaqe, te cilat mund te germohen me mjete te mekanizuar pa patur nevojten e perdorimit te lendeve plasese
- Hidrografia e zones ne pergjithesi dhe e pjeses se kerkuar per leje minerare ne vecanti , e cila nuk krijon problem per shfrytezimin e vendburimit
- Koeficienti I konsiderueshem I nxjerrjes, ne saje te te cilit ka nevoja per siperfaqe te medha te depozitimit te perhershem ose te perkohshme te sterileve.
- Mundesia per mekanizim dhe rritje te prodhimit sipas kerkesave te tregut
- Siguria e larte ne pune

2.6.2 Kapaciteti nxjerrës i minierës, regjimi i punës

Prodhimi I realizuar nga shfrytezimi i ketij vendburimi , do te kete si destinacion kryesisht per eksport, drejtim ky paresor ku mbeshtet strategjia e rritjes dhe zhvillimit te saj kompania.

Percaktimi I kapacitetet vjetor te shitjes pre 10000 m³/vit bllaqe, eshte bazuar ne realizimin e faktit te ketij treguesi ne vite si dhe nga diktimi per te qene ne perputhje me nevojat e tregut te shitjes. Megjithate, ne sasine e rezervave te planifikuara per tu shfrytezuar prej 2,196,900 m³, me sigurimin e nje numri te konsiderueshem te fronteve te punes, projektuesi ka siguruar mundesine e realizimit ten je kapaciteti prodhues deri ne 20 000 m³/vit bllaqe.

Regjimi i punes

Per realizimin e volumit te punes parashikuar per vitin ne vazhdim, ne karriere do te punohet 12 muaj ne vit: me 25 dite/muaj, me nje nderrese

2.6.4 Sistemi i shfrytëzimit

Ne realizimin e volumit të punës do të përdoret shfrytëzimi në qiell të hapur. Sistemi i shfrytëzimit me transport automobilistik dhe me depozitim të mbetjeve minerare në sheshet e planifikuara për ruajtjen dhe trajtimin e tyre sipas kërkesave ligjore

Transporti i dherave dhe mbetjeve shkembore, si dhe blloqeve të përgatitura, bëhet me kamion me kapacitete 9-12 ton.

Sterilet e depozituara (dhëra dhe shkembje me fraksione të vogël) do të përdoren për mbulim të sipërfaqes së shfrytëzuar në vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit.

Elementet e sistemit të shfrytëzimit

Elementet e sistemit të shfrytëzimit që parashikohen të përdoren do të jenë ato elemente që janë përdorur dhe përvetësuar nga punonjësit gjatë viteve të kaluara.

- Lartësia e shkallës së karrierës është 10-12 m
- Lartësia e nënshkallës do të jetë e variueshme në varësi të kushteve të terrenit, për pjesën e shkëmbinjve me çarje që shkon 3-5 m, dhe për pjesën e shkëmbinjve monolite 10 deri 12 m
- Gjerësia e shiritit të punës në gjendje fillestare 06-08 m, në vazhdimësi ruhet gjerësia jo më e vogël se 15 m dhe në gjendje përfundimtare të shfrytëzimit është 3 m
- Këndi i skarpës të perkohshme në shkallët normale të punës në shkëmbinj me çarje është $73^{\circ} - 90^{\circ}$
- Ngarkimi dhe transporti i sterileve dhe blloqeve të prodhuar është i mekanizuar
- Rrezimi i gurit gelqeror, në masivin me çarje të pjesës së sipërme, i mekanizuar me koven e eskavatorin dhe çekicin e tij.
- Ndarja e blloqeve monolite nga masivi i gelqeroreve është i mekanizuar, prerje me tel të diamantuar.

2.6.5 Përcaktimi i mjeteve të ngarkimit të sterileve

Për ngarkimin e sterileve dhe mbetjeve të dala gjatë nxjerrjes së blloqeve të mermerit si dhe vete blloqeve të nxjerra, përdoren mjete ngarkimi fadroma topi "Zeppelin" me kapacitet kove 1.5 m^3 tipi "980G Wheel Loader" me kapacitet kove 3.8 m^3 si edhe eskavator me zinxhirë tipi "RH 12.5" me kapacitet të koves 1.76 m^3 . Mjete të tilla shoqëria ka në dispozicion disa në objekt. Volumi i punës që kryhet nga këto është minimale krahasuar me mundësinë teknike gërmese e ngarkuese e tyre.

Dy eskavatore janë plotësisht të mjaftueshëm për realizimin e volumit të punës. Megjithatë shoqëria disponon në objekt edhe 4 mjete fadroma që shërbejnë për ngarkime e transporte të brendshme në distanca të vogla.

Për transport përdoren automjete vetëshkarkuese me kapacitet të karrocërve 9-12 m^3 .

2.7 Sigurimi teknik dhe mbrojtja në punë

Gjate ushtrimit të aktivitetit minierar subjekti ka parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë me të rëndësishme dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Në vecanti vlerësohet zbatimi i projektit teknik dhe kualifikimi i punonjësve me programe të vecanta për të përvetësuar dhe njohur me mirë proceset e punës dhe teknologjinë që përdoret në objektin minierar.

Drejtuesi teknik i punimeve, para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e përcaktuara në :

Rregulloren e teknikës së sigurimit për Minierat dhe Krrierat të Vitit 1999 të hartuara nga instituti i Teknologjisë nxjerrëse dhe përpunuese të Mineraleve të miratuar me urdher të Ministrit Nr. 132 datë 07.04.1999, mbështetur në nenin 17 të Ligjit Minierar Shqiptar nr 7796 datë 17.02.1994, botuar në vitin 2001.

Rregulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit të punimeve dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces pune të përcaktuar në plan – organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe të miratuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe të miratuar nga drejtuesi i firmës, i cili duhet të përmbajë:

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet parafillimit të punimeve;
- Plan organizimi i punës hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të punimeve minierare të çdo lloji për të cilat objekti ka marrë leje shfrytëzimi;
- Radha e kryerjes do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko – organizative dhe do të miratohet nga drejtuesi i firmës;
- Në këtë plan tekniko-organizativ, masat e teknikës së sigurimit do të zënë vendin kryesor;
- Drejtuesi teknik i punimeve do të kryejë inspektime të rregullta mujore dhe tre mujore, ku do të trajtohen temat e vështira për të gjitha profesionet;
- Punonjësit, që do të punojnë në karriera për kontrollin e shpateve të shkalleve, shesheve të ngarkimi, rrugëve të transportit, etj. do të instruktohen rregullit dhe do të nderjkin me rigorozitet zbatimin e rregullave dhe normave të Rr.T.S., që lidhen me këto probleme.
- Kujdes i veçantë do të tregohet me krijimin e kushteve të punës, pastrimit të shesheve të shkalleve, rrugëve të transportit, krehjes dhe skarifikimit të shpateve të shkalleve të punës dhe nënshkalleve sidomos kur punohet në zonën me shkëmbinj me çarje dhe kohe me lageshti;
- Do të zbatohet një regjim i repte në aplikimin e pasaportave teknike të punimeve në përdorimin e materialeve eksplozive, të punimeve në ndarjen e blloqeve si edhe në proceset e ngarkimit të transportit.

2.8 Pjesa ndërtimore

Shfrytëzimit të gurit gelqeror të këtij objekti është një aktivitet i mirëfilltë mineral i subjektit për sigurimin e lëndës së parë të prodhimit në blloqe masive të gëllorit të mermerizuar.

Për hapjen, përgatitjen, shfrytëzimin e gurit gelqeror dhe kryerjen e proceseve të tjera të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve, janë realizuar investimet e nevojshme që garantojnë vazhdimësinë dhe sigurimin për rritjen e metejshme të kapaciteteve prodhuese. Megjithatë, në hapjen dhe përgatitjen e metejshme të objektit, për të siguruar prodhimin e planifikuar në periudhën shtesë, është e nevojshme që të investohet në ndërtimin e rrugëve dhe shesheve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të shfrytëzimit në kushte normale, sipas projektit të paraqitur për miratim.

Rrugët për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit

Për hapjen e objektit në drejtimin e Veriut, do të hapet një rrugë e re, si vazhdim i rrugës në nivelin e sheshit të shkallës nr.11 (+1249 m) që do ta lidhë atë me sheshet e shkallëve mbi këtë nivel, pra për hapjen e shesheve deri në shkallën nr.16 (+ 1287 m). Njehkohësisht, për hapjen e pjesës fundore të objektit, do të në nivelin e sheshit nr. +1199 m, do të vazhdojë ndërtimi i rrugës përhapjen e shesheve për shkallët deri në nivelin (+1242 m). (shih projektin e hapjes) Rruga është parashikuar të hapet me përqindje 8-10% .

Është kjo rrugë, me çdo nivel të shkallëve ekzistuese, do të hapen transhete e hyrjeve në objekt, për çdo shkallë dhe në shkallë. Transhete do të përshkojnë formacione të forta dhe të dendurshme. Zgjedhja e skarpates së transeve do të varet nga shtrirja e tyre në raport me enien e gelqeroreve, dhe do të jete nga 68⁰ deri në 73⁰

Objektet industriale të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve

Në objekt nuk parashikohen të ndërtohen objekte industriale dhe të shërbimit, sepse janë të ndërtuara.

Objektet sipërfaqësore dhe sociale

Që në fillim të aktivitetit të tij subjekti ka ndërtuar ambiente që shërbejnë si zyrë dhe ambient pushimi.

Furnizimi me energji elektrike dhe telefoni

Që në fillim të aktivitetit të tij subjekti ka investuar për sigurimin e energjisë së nevojshme elektrike. Për këtë arsye është ndërtuar një linjë dhe një kabine elektrike e pajisur me transformator dhe të gjithë aksesoret e nevojshme.

Lidhja telefonike e objektit me subjektin bëhet me telefona mobile.

Furnizimi me ujë

Procesi teknologjik i konturimit prerjes dhe shkeputjes së blloqeve kërkon sasinë e nevojshme të ujit teknologjik. Për këtë arsye, subjekti ka investuar fillimisht në ndërtimin e një ujësjelesi me gjatësi rreth 1.2 km dhe të një stacioni të vogël pompimi. Me shterimin e ujit në burimin, subjekti u detyrua të investoi në ndërtimin e një shpimi nga sipërfaqja me gjatësi 900 ml, dhe vlerën 7,200,000 lekë. ku merret uji, dhe pompohet në pjesën e sipërme të objektit.

Objekte të tjera

Në objekt janë të ndërtuara objekte, si ambiente magazine dhe sisteme të ndryshme në zonën ku është qendra e sektorit .

Kapitulli 3: PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONË

Vendburimi i gurit gelqeror te mermerizuar ndodhet ne territorin e fshatit Mëlovë, te Njesise Administrative Gjerbës, bashkise Skrapar, ne te majte te rruges qe lidh fshatin Mëlovë me fshatin Zaloshnje rreth 1 km large fshatit Mëlovë . Kjo zone eshte nje pjese e shpatit perendimor te malit te Zaloshnjes kufizuar me kuotat 1180 dhe ngjitet ne lartecin e malit ne afersi te kuotave 1500 m. Ne pjesen lindore ky objekt kufizohet nga rruga automobilistike , kurse nga ana Perendimore, Veriore dhe Jugore kufizohet me shpatin e malit te Zaloshnjes. Vendburimi I Gurit Gelqeror te mermerizuar ndodhet ne verilindje te qytetit te Çorovodes, ne distance 10 km large nga qyteti. Shtrirja e kesaj siperfaqeje eshte VeriPerendim-JugLindje .

3.1 Mjedisi fizik

3.1.1 Gjeologjia

Siperfaqja ne te cilen zhvillohet aktiviteti i shfrytezimit eshte formacion shkembor karbonatik perfaqsuar nga gelqerore te mennerizuar dhe koralore masive. Zona ne te cilen ndodhet objekti perfaqson nje pjese te shpatit te malit qe lidhet me tej me ate te Qafes se Devrise dhe qe perfaqsojne vazhdimin e malit te Tomorit, dhe ben pjese ne zoncn Gjeologo-Tektonike – Jonike. Ndertimi gjeologjik dhe petrogratik i kesaj zone ka qene objekt studimesh dhe pergjithesimesh te kryera nga Fakulteti i Gjeologjise dhe Minierave, publikimesh te ndryshme te Specialisteve te Institutit te Studimeve dhe Projekttimeve Gjeologjike ne buletin e Gjeologjise deri ne vitin 1990, punime e ndryshme te kryer per harten gjeologo strukture te vendit. Por, duhet theksuar se se fundi ne kete zone jane kryer punime kerkim zbulimi nga subjekti "Stone Production" SHPK, te cilat me informacinin e marre edhe gjate zhvillimit te aktivitetit minerar, kane siguruar material te bollshem per gjeologjine e zones. Zona e studjuar, ku jane kryer dhe punime kerkim zbulimi dhe shpime te ndryshme ben pjese ne shpatin lindor te malit te Koritas. Mali i Korites ka nje shtrirje te pergjitheshme VP-JL, me azimut 320°-340°, me nje gjatesi rreth 15 km dhe gjeresi qe shkon 3-5 km. Siperfaqja e tij eshte rreth 42-75 km². Maja me e larte e tij eshte ajo e Kulmakut 2.174 m . Ai ka renie ne te dy krahet perkatsisht:

- Ne VL me azimut renie 500-600 dhe kend renie te terenit 300-320 .
- Ne JP me azimut renie 220°-235° dhe kend renie te terenit te ndryshueshem ne pjesen nen kuoten +1350m, 29°-36° , per pjesen mbi kte kuote kuoten, 450-680. Ne vetevete, ky mal perfaqson vazhdimin ne Juge Lindje te rnalit te Tornorit

Ai perfaqson ne veteve dhe depozitime te Kretakut te mesem Cr2 te cilat, me vone jane prekura edhe nga tektogjeneza e Oligocenit te meson. Ne ndertimin gjologjik te rajonit dhe me gjere, rnarrin pjese shkembinjte sediment qe fillojne me gelqeroret c Kretakut Cr2 dhe Pg2 1-2 formacionet flishore te Paleogenit Pg31 dhe Pg32 dhe me te reja te kuaternarit Qi -3c te tipit deluvioneve dhe fushave kartike

Depozitimet karbonatike te Kretakut te siperperm;

Depozitimet karbonatike te Kretakut te siperperm, jane shkembenjte kryesore qe ndrcetojne Malin e Tomorit dhe ne vazhdim te tij ate te Meloves. Te cilat perfaqesohen teresisht nga tipi i gelqerorit masiv ose ne disa raste shtrese trashe. Jane me ngjyre hiri te celet deri ne te bardhe, bezhe te celet deri ne te erret dhe nganjehere deri ne te mbyllur , me kokriza me diameter 0.01-0.02mm,

Kane thyerje guackore me tehe relativisht te mprehta. Ne thyerje te fresket kane pothuajse te gjitha ngjyrat e permendura me siper. Ne pergjithesi jane kompakte, ne siperfaqe shume pak te karstezuar, me ndertim kryesisht homogjen, me strukture kristaline, paraqiten masive dhe ne disa raste ne kufijte tektonike me shtresezim te trashe. Gelqeroret ne pergjithesi praqiten ne forme pakosh masive te mbivendosura mbi njera-tjetren

3.1.4 Hidrologjia

Sic u permend me siper vendburimi gjeografikisht perfaqeson nje strukture monoklinale, ne formen e nje shpati plotesisht te drenuar dhe nuk ka permbajtje ujrash ne te, me perjashtim te ndonje sasive te vogel ne kuotat e poshteme mbi kuoten e rruges qe vjen nga Milova dhe shkon ne Zaloshnje dhe te proskave, qe ndodhen ne zonen e tij.

Per nga pikparnja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku ushtrohet aktiviteti minerar ndodhet nje prroske e thelle rreth 20 m ne te cilen ne stinen e thate nuk rrjedhin ujra.. Kur ka rreshje ne to rrjedhin me rrrenbim ujra siperfaqesore per shkak te pjerresise se madhe te terrenit

Per nevoja teknologjike, eshte realizuar nje shpim me sonde, me gjatesi 900 ml, me anen e te cilit sigurohet uje teknologjik. Prania e ujrave te rreshjeve te shiut nuk veshtiresone kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato mund te rrjedhin ne drejtim te shpatit te kodres si dhe pergjate rrugeve qe lidhin e do te ndertohet per lidhjen e objektit me ate ekzistuese. Rreshjet c deboret veshtiresojne kryesisht transportin e materialit te prodhuar ne karriere, i cili per arsye te tyre, nderpritet per intervale te kufizuar kohe

Persa i perket kryerjes se proeeseve teknologjike te shpimit te birave konturuese apo udhezuese, rrezimit, shkeputjes se materialit dhe blloqeve ne karriere zbankimit the ngarkimit te tyre ndikimi i rreshjeve te deboret do te jete reiativisht i kufizuar me perjashtim te rasteve te ternperaturave te u]ta dhe ngricave.

Sipqefaqja e vendit qe do te shrytezohet eshte pothuajse e zhveshur nga birnesia, Rriten vetem pak shkurre te vogla barishtore. Te gjitha llojet e birneve, (qe rriten perreth objektit jane te karakterit lokal pa ndonje vecori dalluese dhe qe nuk gezojne ndonje status te vecante mbrojtjeje. Brenda zones se shfrytezimit jane te zhvilluar ne rnenyre te kufizuar shkurret dhe bimet lokale. Ne pjesn fundore te objekti ne zone Vcriore dhe Veriperendimore pergjate, rritcn bimcsi me te larta te tipit te shkozës dhe ahut Kjo pjese e zone nuk parashikohet te preket nga shfrytezimi.

Kapitulli 4: IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË VEPRIMTARISË

4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin ndikimeve në mjedis

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Për një vlerësim sa më profesional të ndikimeve dhe pasojave të projektit në mjedisin fizik dhe social është përzgjedhur të aplikohet metodika dhe procedura e mëposhtme:

- Identifikimi dhe njohja e të gjithë aktiviteteve të projektit;
- Identifikimi i ndikimeve të mundshme dhe me pasoja të rëndësishme në mjedis për çdo aktivitet, kjo bazuar edhe në studimin e gjendjes së mjedisit dhe projektit teknik;
- Krahasimi i ndikimeve të mundshme me kushtet dhe gjendjen egzistuese të zonave të projektit;
- Vlerësimi dhe kategorizimi i çdo ndikimi të mundshëm dhe të identifikuar duke përdorur matriksin e kategorizimit më poshtë;
- Zhvillimi i një materiali të permbledhur ku sqarohet mënyra e vlerësimit dhe kategorizimit të ndikimeve të mundshme të projektit.

Industria minerare shoqërohet edhe me ndikime mjedisore negative, të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme. Megjithatë, shumë prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshëm mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjisë së parandalimit të ndotjeve.

4.2 Metodika e kategorizimit të ndikimeve të identikuara (sinjifikanca)

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identikuara gjatë procesit të VNM dhe për të ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, është bërë një kategorizim i rëndësishëm së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të aktivitetit të propozuar. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

4.3 Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis të veprimtarisë

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në tokë

Operacionet e punës	Ndikimi i mundshëm
Operacionet e gërmimit për rikonstruksionin e rrugës së hyrjes dhe atyre lidhëse ndërmjet shkallëve të karrierës si dhe për nxjerrjen e gurit gelqeror te mermerizuar	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshim i destinacionit të përdorimit të tokës; • Shqetësim i shtresës së tokës dhe dëmtim i strukturës së saj. Ndikim në zhvillimin e proceseve të tokëformimit etj. në sipërfaqen e prekur; • Erozion në kohë me reshje pasi pjerrësia e terrenit bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit.
Përdorimi i mekanikës dhe automjeteve të transportit	<ul style="list-style-type: none"> • Shqetësim i shtresave të tokës dhe ngjeshje e saj; • Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanikës të cilat mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantesh.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ajër

Operacionet e punës	Ndikimi i mundshëm
Operacionet e gërmimit për rikonstruksionin e rrugës së hyrjes dhe atyre lidhëse ndërmjet shkallëve të karrierës si dhe për nxjerrjen e gurit gelqeror te mermerizuar	<ul style="list-style-type: none"> • Gjenerim i një sasive pluhuri, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë; • Duke qenë se të gjitha mjetet dhe makineritë që do të përdoren në karrierë janë me motor me djegie të brendshme, do të emetohen në ajër sasi të caktuara të gazeve të djegies NO_x dhe SO_x; • Emetim i zhurmave.
Përdorimi i mekanikës dhe automjeteve të transportit	<ul style="list-style-type: none"> • Duke qenë se të gjitha mjetet dhe makineritë që do të përdoren në karrierë janë me motor me djegie të brendshme, do të emetohen në ajër sasi të caktuara të gazeve të djegies NO_x dhe SO_x; • Emetim pluhurash; • Emetim zhurmash dhe vibrime të ajrit.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në ujëra

Operacionet e punës	Ndikimi i mundshëm
Përdorimi i mekanikës dhe automjeteve të transportit	<ul style="list-style-type: none"> • Avaritë e mekanikës mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantesh, të cilët nën veprimin e ujrave të shiut mund të shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në biodiversitet

Operacionet e punës	Ndikimi i mundshëm
Operacionet e gërmimit për rikonstruksionin e rrugës së hyrjes dhe atyre lidhëse ndërmjet shkallëve të karrierës si dhe për nxjerrjen e	<ul style="list-style-type: none"> • Siç është treguar në përshkrimin e mjedisit, sipërfaqja e objektit është në pjesën më të madhe e zhveshur nga bimësia, kështu që hapja e shkallëve të karrierës nuk do të shoqërohet me dëmtim të konsiderueshëm të flores. Megjithatë prishja e shtresës së tokës do të zvogelojë hapësirën e habitatit natyror

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E VNM-se

gurit gelqeror te mermerizuar

per zhvillimin e metjeshem te flores.

- Disa procese që lidhen më shumë me shqetësimet dhe cilësinë e mjedisit, do të ushtrojnë ndikimet e tyre në botën e gjallë, veçanërisht mund të mbajnë larg zonës disa lloje shtazore.

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në pejsazh

Operacionet e punës

Operacionet e gërmimit për rikonstrukcionin e rrugës së hyrjes dhe atyre lidhëse ndërmjet shkallëve të karrierës si dhe për nxjerrjen e gurit gelqeror te mermerizuar

Ndikimi i mundshëm

Ndër ndikimet më evidente do të jenë ndryshimet në pjerrësinë e terrenit dhe ato vizuale të pejsazhit.

Mbetjet e ngurta

Operacionet e punës

Operacionet e gërmimit për rikonstrukcionin e rrugës së hyrjes dhe atyre lidhëse ndërmjet shkallëve të karrierës si dhe për nxjerrjen e gurit gelqeror te mermerizuar

Ndikimi i mundshëm

- Gjenerim i një sasive dheu si rezultat i punimeve të zbulimit;
- Gjenerim i mbetjeve urbane nga aktiviteti njerëzor: kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjësve.